ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11 (8)
2

Tirane, 5 Qershor 1942

I ndershem im Uugj,

Po ju shkruaj perseri passi kemi pritur kaq kohe te marrim nonje letre nga juve, por me kot. Çuditemi dhe jemi shume merak per kete heshtjen t'uaj. I shkrojta edhe z. K. Mima qe te me jepte nonje lajm per juve, por mjerisht as ay nuk u-pergjegj.

Librat ju-a dorguam, ka afer dy muaj, me nje person qe rekomandoi z. Meksi.

Ju kisha shkrojtur me pare qe te vini, po te deshironi, fundit edhe si privat, mbasi s'u be gje per rimarrjen e vendit t'uaj si Mitropolit. Sinodhi ketu ka mbledhje keto dit. Esht dorezuar edhe nje Ndihmes Episkop i ri me titullin "i Apollonise". Nga Imzot Vissarioni, qe ndodhet ketu keto dit dhe e kishim per vizite, kini pershendetje vllazrore.

Me shtepi jemi mire te gjithe dhe ju puthim dore ime-shoqe dhe femija. Ka nje muaj qe kam

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

ketu dhe Nenen t'ime dhe vllane Kla-
gin, i cili zu pune ketu (familjen e tij e
ka ne fshat).

Do t'ju lutem te beni mundimin
te gjeni dhe te me dergoni disa libra,
drama e komedi ne gjuhen greqishte
(Ξενοπούλου, Σ. Μελά etj.), se me duhen
per perkethim per Radio-Tiranen. Te
jene te vogla dhe te pershtateshme
per popullin t'one. Ne qofte se
s'kini tjeter rast per t'i derguar,
mund t'ja dorezoni Com. Grazioli-
ne Legaten Italiane atje dhe t'i
thone qe t'i dergonje ne Radio
Tirana ketu, mbi emrin t'em. Do
te me detyroni shume po te m'i
dergoni.

Por mbi te gjitha deshiroj
te marr lajme per shendetin
t'uaj dhe uroj qe t'ju degjoj mire.

Nipi i juaj
Vasili

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ